



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24.02.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03/14
PËR/ZA/TO:	z. Feim Salihu, Kryeshef Ekzekutiv - Kompanin Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi"
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Salihu,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe nenit 22 (paragrafi 1 dhe 2) të Rregullores së Punës nr.02/2013 të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Agjencia kundër Korrupsionit, në bazë të detyrës zyrtare, dhe pastaj me kërkesën tuaj, ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksioneve publike si Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" dhe Anëtarit të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës paraqet papajtueshmëri të funksioneve dhe konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën për trajtimin e rastit me nr. protokolli AKK-03-260/14 për z. Feim Salihu, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme me ligjet në fuqi, si Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" dhe njëkohësisht Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit, në bazë të kompetencave të parapara me ligj, bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave, neni 19 (paragrafi 5) i Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në bazë të nenit 6 të këtij ligji, konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Rrjedhimisht, neni 8 (paragrafi 1,2,3,4,5,6) përcakton detyrimet e zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Ndërsa, neni 16 i këtij ligji, përcakton kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik. Në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë dedikohet për shkak të funksionit.

Në anën tjetër, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ka paraparë obligimet për zyrtarët e lartë publik.

Në bazë të nenit 65 (pika 2) të këtij ligji, drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës ku ata punojnë.

Andaj, ushtrimi i funksioneve publike si Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" dhe Anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës, është i ndaluar në bazë të dispozitave të lartpërmendura. Për më tepër, kjo paraqet mospajtueshmëri dhe gjendje të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Prandaj, konform kësaj, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit dhe ta njoftoni Agjencinë për masat e ndërmarra.

Me respekt!